

**A BI ESSE Sh.p.k.**  
**PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUdhËN USHTRIMORE QË PERFUNDOI MË**  
**31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

---

*SHUMAT NË LEK. PËRNDRYSHE SHKRUIJET*

**“A BI ESSE ” Sh.p.k.**

Selia: Rruga 28 Nëntori Nr. 73, Kashar, Yrshek  
Tiranë – Albania

**Pasqyrat Financiare për periudhën e mbyllur me 31 Dhjetor 2019**

( me raportin e audituesit të pavarur ne vazhdim)

Tiranë më, 28 Prill 2020

**A BI ESSE Sh.p.k.**  
**PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QË PERFUNDOI MË**  
**31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

---

*SHUMAT NË L.E.K. PËRNDRYSHJE SHKRUHJET*

**Përmbajtja**

1. Opinioni i Audituesit të Pavarur
2. Bilanci Kontabël
3. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve
4. Pasqyra e flukseve monetare
5. Pasqyra e ndryshimeve në kapital
6. Shënime shpjeguese

# RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

**Për Ortakëve të Shoqërisë**

**“A BI ESSE” Shpk**

**Kapitali i regjistruar ne QKB-ne prej 450,000 mije leke**

**Komuna Kashar, Lagjja Yrshek, Rruga 28 Nëntori,**

**Tiranë - Shqipëri**

## Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregtare “A BI ESSE“ sh.p.k. (shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2019, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur me datën 31 Dhjetor 2019, si edhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin me Rezervë të raportit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për) pozicionin financiar të shoqërisë “A BI ESSE“ sh.p.k. me datën 31 Dhjetor 2019, dhe performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Ligjin nr. 25/2018 date 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit që zbatohen në Shqipëri.

## Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit të Përgjegjësive të Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare (të zbatueshme në juridiksionin përkatës) dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

## Cështje për tu theksuar

Shoqëria ka përpiluar pasqyrat financiare 2019, pas dates te shpalljes te pandemise boterore Covid-19. Drejtimi ka vleresuar se efektet e pandemise nuk do te cenojne vijimesine e shoqerise. Kohëzgjatja dhe ndikimi i pandemisë COVID-19, si dhe efektiviteti i përgjigjeve të qeverisë dhe bankës qendrore, mbetet i paqartë në këtë kohë.

## Përgjegjësitë e Drejtimit dhe Organeve të Qeverisjes për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare që japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Drejtimi ka gjithashtu, përgjegjësinë për të vlerësuar aftësinë e shoqërisë për të vazhduar veprimtarinë në vijimësi, duke dhënë për këtë qëllim, kur është rasti, informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë nisur nga parimi kontabël i vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likujdojë shoqërinë, të ndërpresë aktivitetet e saj, ose rasteve kur drejtimi nuk ka alternativë tjetër reale përveç likujdimit të shoqërisë.

Organet e ngarkuara me qeverisjen kane përgjegjësi për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona të auditimit janë: të arrijmë një siguri të arësyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi kanë ose jo anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport, i cili përfshin opinionin e auditusit. Siguria e arësyeshme megjithëse është një siguri e nivelit të lartë, nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku pritet, që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Nje auditim i pasqyrave financiare në përputhje me SNA-të, kërkon që ne si auditues të ushtrojmë gjykimin profesional dhe të ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku i anomalise materiale si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara ose anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë dhe, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Kur arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

### **Audituesi ligjor**

Eda **ABAZI, (AL/CPA)**  
Partner Auditimi  
Rruga e Barrikadave Ish Kinema 17 Nentori,



26 Qershor 2020

**A BI ESSE Sh.p.k.**  
**PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUdhËN USHTRIMORE QË PERFUNDOI MË**  
**31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

SHUMAT NË LEK. PËRNDURYSHE SHKRUHET

**Bilanci Kontabël për periudhën që mbyllet më 31.12.2019**

**AKTIVET**

**Aktivët Afatshkurtëra**

**Aktive monetare**

**Aktive të tjera financiare afatshkurtra**

*Llogari/Kërkesa të arkëtueshme*

*Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme*

**Totali**

**Inventari**

*Mallra për rishitje*

*Parapagesat për furnizime*

*Inventar i imet/Të tjera gjëndje inventari*

**Totali**

**Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra**

**Total i Aktiveve Afatshkurtra (I)**

**Aktivët afatgjata**

**Investimet financiare afatgjata**

**Aktive afatgjata materiale**

*Toka*

*Ndërtesa*

*Makineri dhe pajisje*

*Aktive të tjera afatgjata materiale (me vl.kontab.)*

*Aktive afatgjata materiale ne poces*

**Totali**

**Aktivët afatgjata jomateriale**

*Aktive të tjera afatgjata jomateriale/L.licenca*

**Totali**

**Totali i aktiveve Afatgjata (II)**

**TOTALI I AKTIVEVE (I + II)**

**DETYRIMET DHE KAPITALI**

**DETYRIMET Afatshkurtëra**

**Huamarrjet**

*Huat afatshkurtra - Overdrafte*

*Huamarrje afat-shkurtra*

**Totali**

**Huat dhe parapagimet**

*Të pagueshme ndaj furnitorëve*

*Të pagueshme ndaj punonjësve*

*Detyrime tatimore*

*Hua të tjera*

*Parapagimet e arkëtuara*

**Totali i detyr. afatshkurtra**

**DETYRIME AFATGJATA**

**Huat afatgjata**

*Huamarrje të tjera afatgjata*

**Totali**

**Provizionet afatgjata**

**Totali i detyr. afatgjata**

**Totali i detyrimeve**

**Kapitali**

*Kapitali aksionar*

*Rezerva ligjore*

*Rezerva të tjera*

*Fitimet e pashpërndara*

*Fitimi (humbja) e vitit financiar*

*Të tjera (kapital i falur)*

**Totali i kapitalit (III)**

**TOTALI I DETYRIMEVE KAPITALIT**

Shen	31.12.2019	31.12.2018
4	9,621,897	27,774,639
5.1	175,046,589	135,928,976
5.2	60,993,531	30,820,991
	<b>236,040,120</b>	<b>166,749,968</b>
6	451,563,745	463,924,536
6	1,375,625	3,909,680
6	1,213,675	1,109,482
	<b>454,153,045</b>	<b>468,943,698</b>
6.1	3,735,630	5,414,448
	<b>703,550,692</b>	<b>668,882,753</b>
	-	-
7	339,709,288	339,082,845
7	18,354,048	19,320,051
7	27,716,339	25,749,008
7	21,186,701	16,479,429
7	20,393,797	20,393,797
	<b>427,360,173</b>	<b>421,025,131</b>
7	568,996	728,297
	<b>568,996</b>	<b>728,297</b>
	<b>427,929,169</b>	<b>421,753,428</b>
	<b>1,131,479,861</b>	<b>1,090,636,181</b>
8.1	225,901,311	141,815,310
8.1	9,366,904	22,785,238
	<b>235,268,215</b>	<b>164,600,548</b>
8.2	151,257,709	168,054,554
8.3	324,031	2,283,449
8.4	4,524,870	14,643,568
8.5	87,872,242	2,655,205
8.6	1,355,990	
	<b>480,603,057</b>	<b>352,237,324</b>
9	42,010,650	39,114,627
	<b>42,010,650</b>	<b>39,114,627</b>
	0	0
	<b>42,010,650</b>	<b>39,114,627</b>
	<b>522,613,707</b>	<b>391,351,950</b>
10	450,000,000	450,000,000
10	40,585,570	33,772,078
10	69,502,251	79,092,308
10	0	0
10	48,628,333	136,269,844
10	150,000	150,000
	<b>608,866,154</b>	<b>699,284,230</b>
	<b>1,131,479,861</b>	<b>1,090,636,180</b>

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese pikat 1-14

**A BI ESSE Sh.p.k.**  
**PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUdhËN USHTRIMORE QË PERFUNDOI MË**  
**31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

SHUMAT NË LEK. PËRNDRYSHË SHKRUHET

**Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve Gjithpërfshirëse për periudhën 1 janar deri 31 dhjetor 2019**

		Viti 2019	Viti 2018
Shitjet neto	11.1	1,152,789,582	1,147,577,169
Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	11.2	40,891,998	31,608,546
Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatëshme dhe prodhimit në proces		-	-
Materialet e konsumuara	11.3	-934,217,378	-842,041,280
Kosto e punës			
-Pagat e personelit	11.4	-78,817,957	-67,264,742
-Shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	11.4	-10,820,281	-9,616,175
Amortizimi dhe zhvleresimet	11.5	-10,438,853	-11,000,682
Shpenzime të tjera	11.6	-102,494,552	-111,885,771
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>-1,136,789,021</b>	<b>-1,041,808,649</b>
<b>Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore</b>		<b>56,892,559</b>	<b>137,377,066</b>
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare:			
Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi	11.7	-5,897,917	-5,426,883
Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi	11.8	6,914,472	29,301,902
Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare		-	-
<b>Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare</b>		<b>1,016,556</b>	<b>23,875,019</b>
<b>Fitimi (humbja) para tatimit</b>		<b>57,909,115</b>	<b>161,252,085</b>
Shpenzimet e tatimit aktual mbi fitimin	12	-9,280,782	-24,982,241
<b>Fitimi (humbja) neto e vitit financiar</b>		<b>48,628,333</b>	<b>136,269,844</b>
<b>Të Ardhura të Tjera gjithpërfshirëse</b>			
Fitimi (Humbje) nga rivlerësimi i AAM		-	-
Fitimi (Humbje) nga rivlerësimi i AAFinacniare		-	-
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse neto nga tatimet</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i të ardhurave neto gjithpërfshirëse për periudhën</b>		<b>48,628,333</b>	<b>136,269,844</b>

*Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese pikat 1-14*

Pasqyrat Financiare të shoqërisë A BI ESSE Sh.p.k. janë përgatitur nga Drejtimi i Shoqërisë më

28 Prill 2020

JONIDA HOXHA

Përgjegjës i Kontabilitetit

RAF PILIKA

Administrator



**A BI ESSE Sh.p.k.**  
**PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QË PERFUNDOI MË**  
**31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

SHUMAT NË LEK. PËRNDRYSHË SHKRUHET

**Pasqyra e flukseve monetare për periudhën 1 janar deri 31 dhjetor 2019**

<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit</b>	<b>2019</b>	<b>2018</b>
Fitim / Humbja e vitit	48,628,333	136,269,844
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare		
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	-	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10,438,853	11,000,682
Diferenca kursi kembimi	-	-
Shpenzime të llogaritura për interesat	-	-
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	-69,290,153	-12,347,242
Rënie/(rritje) në inventarë	14,790,653	-35,322,133
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	-16,796,845	11,631,431
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	-1,959,418	2,283,449
Rritje/(rënie) në shpenzimet e shtyra	1,678,818	-2,033,489
Rritje/(rënie) në parapagimet e arketuara e të tjera	86,573,028	-173,026
Rritje/(rënie) në detyrimet tatimore	-10,118,698	11,789,627
Rritje/(rënie) në Hua dhe Obligacione Afatshkurtra	70,667,667	-13,327,603
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit</b>	<b>134,612,238</b>	<b>109,771,539</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	-17,737,282	-48,688,863
Arkëtime nga shitja / nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata materiale	1,122,688	18,069,674
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>	<b>-16,614,594</b>	<b>-30,619,189</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>		
Hua bankare e të tjera	2,896,023	-27,564,898
Dividendë të paguar	-139,046,409	-38,947,472
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>	<b>-136,150,386</b>	<b>-66,512,370</b>
	<b>-18,152,742</b>	<b>12,639,980</b>
<b>Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare</b>	<b>27,774,639</b>	<b>15,134,659</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar</b>	<b>9,621,897</b>	<b>27,774,639</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor</b>		

*Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese pikat 1-14*



**A BI ESSE Sh.p.k.**  
**PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QË PERFUNDOI MË**  
**31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

*SHUMAT NË LEK. PËRNDRYSHË SHKRUHET*

**Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital për periudhen 1 janar deri më 31 dhjetor 2019**

	Kapitali aksionar	Rezerva statusore dhe ligjore	Fitimi i pashpërndarë	Rezerva të tjera	Kapitali i falur	Totali
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2017</b>	<b>450,000,000</b>	<b>26,597,378</b>	<b>72,680,421</b>	<b>52,534,059</b>	<b>150,000</b>	<b>601,961,858</b>
Efëkti i ndrysh. në politikat kontabël						
<b>Pozicioni i rregulluar</b>	<b>450,000,000</b>	<b>26,597,378</b>	<b>72,680,421</b>	<b>52,534,059</b>	<b>150,000</b>	<b>601,961,858</b>
Fitimi neto i periudhës kontabël			136,269,844			136,269,844
Dividendët e paguar/deklaruar				-38,947,472		-38,947,472
Transferime në rezervën e detyrueshme ligjore						-
Transferime në rezervën e detyrueshme statutore		7,174,700		69,046,400		76,221,100
Transferime në rezerva të tjera			-72,680,421	-3,540,679		-76,221,100
Emetim i kapitalit aksionar						-
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2018</b>	<b>450,000,000</b>	<b>33,772,078</b>	<b>136,269,844</b>	<b>79,092,308</b>	<b>150,000</b>	<b>699,284,230</b>
Efëkti i ndrysh. në politikat kontabël						
<b>Pozicioni i rregulluar</b>	<b>450,000,000</b>	<b>33,772,078</b>	<b>136,269,844</b>	<b>79,092,308</b>	<b>150,000</b>	<b>699,284,230</b>
Fitimi neto i periudhës kontabël			48,628,333			48,628,333
Dividendët e paguar/deklaruar						-
Transferime në rezervën e detyrueshme ligjore			-129,456,352	-9,590,057		139,046,409
Transferime në rezervën e detyrueshme statutore		6,813,492	-6,813,492			-
Transferime në rezerva të tjera						-
Emetim i kapitalit aksionar						-
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2019</b>	<b>450,000,000</b>	<b>40,585,570</b>	<b>48,628,333</b>	<b>69,502,251</b>	<b>150,000</b>	<b>608,866,154</b>

*Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese pikat 1-14*



**A BI ESSE Sh.p.k.**  
**PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUdhËN USHTRIMORE QË PERFUNDOI MË**  
**31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

*SHUMAT NE LEX, PERNDRYSHJE SHKRUHET*

## 1. Të përgjithshme

Shoqëria A BI ESSE Sh.p.k. është shoqëri e së drejtës shqiptare me kapital të përbashkët me investitor të huaj. Ajo është regjistruar me vendimin e gjykatës së Rrethit Tiranë Nr.11918 datë 24/08/1995. Objekti kryesor i veprimtarisë së saj është Import-Eksporti dhe tregtimi i artikujve dhe pajisjeve elektrike dhe materialeve të tjera tregtare. Gjatë vitit 2019 nuk ka pasur ndryshime në lidhje me madhësinë dhe me strukturën e zotërimit të kapitalit. Në datën e këtyre PF struktura e kapitalit të shoqërisë paraqitet si vijon.

<u>Ortakët</u>	<u>Perqindja e zotërimit</u>	<u>Shuma e kapitalit ne leke</u>
Raf PILIKA	47.5%	213,750,000
Ret PILIKA	47.5%	213,750,000
Giuseppe SARVIA	5%	22,500,000
<b>Totali</b>	<b>100%</b>	<b>450,000,000</b>

Numri i përgjithshëm i kuotave është 1,000

Administrator i shoqërisë gjatë vitit 2019 ka qenë Z.Raf Pilika.

*Adresa e shoqërisë:* Rruga. 28 Nëntori Nr.73, Kashar, Yrshek – Tiranë.

Shoqëria është e regjistruar si person juridik në Degën e Tatimpaguesve të Mëdhenj me NIPT: J61818010A.

Më 31 Dhjetor 2019 shoqëria ka patur 63 punonjës dhe 31 Dhjetor 2018, 67 punonjës.

## 2. Parimet e përgatitjes së Pasqyrave Financiare

### (a) Deklarata e parimeve kontabël

Shoqëria mban regjistrimet kontabël dhe përgatit pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin kontabël në Shqipëri.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) të përmirësuara.


### Parimet e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike.

Politikat kontabël janë zbatuar në përputhje me kërkesat e SKK-ve dhe të ligjit nr 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe paraqiten në shënimin vijues.

## 3. Politikat Kontabël më kryesore

Një përmbledhje të pjesës më të madhe të Politikave Kontabël mbi bazën e të cilave janë përgatitur Pasqyrat Financiare janë paraqitur sa më poshtë.



**A BI ESSE Sh.p.k.**  
**PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUHDHËN USHTRIMORE QË PERFUNDOI MË**  
**31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

SHUMAT NE LEK, PERNDRYSHJE SHKRUHET

---

### **3.1 Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare**

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë MM ne dore dhe ato te mbajtura ne banka.

Në përputhje me SKK 7 “Pasqyra e fluksit të Mjeteve Monetare”, Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrat e fluksit të Mjeteve Monetare përfshin MM (arkëtimet në MM dhe depozitat me afat) dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare (investimet afat-shkurtra, nëse ka, të cilat janë shumë likuide dhe menjëherë të konvertueshme në një vlerë që njihet me siguri dhe vlera e të cilave ndryshon shumë pak) Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrën e fluksit të Mjeteve Monetare nuk përfshin investimet në letrat me vlerë të listuara, investimet me një datë maturimi fillestare afati i të cilës është mbi tre muaj dhe pa një klauzolë përfundimi më të hershëm të këtij afati, ose llogaritë bankare që kanë kufizime në përdorim., kufizime këto të ndryshme nga ato të cilat janë si pasojë e rregullimeve specifike në një shtet ose sektorë të aktiviteteve (kontrollet e këmbimit, etj).

Overdraftet bankare konsiderohen si financim dhe si rrjedhim përjashtohen nga Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare. Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në bilancin kontabël korrespondojnë me Mjetet monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare sipas përkufizimit të mësipërm.

### **3.2 Aktivet financiare**

Shoqëria i klasifikon aktivet financiare në Llogaritë e Arkëtueshme nga Klientët dhe në Kërkesa të tjera të Arkëtueshme. Menaxhimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare. Aktivet financiare paraqiten në bilanc me vlerën neto nga zhvlerësimi nëse ka.

Llogari të Arkëtueshme njihen si aktive atëherë kur njësi ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë mjete monetare nga klientët e saj. Njohja fillestare e kërkesave për t’u arkëtuar nga klientët ndodh derisa mallrat ose shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer. Kërkesat për tu arkëtuar vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar (kosto fillestare minus arkëtimet e bëra, minus zhvlerësimet nga borxhi i keq nëse ka) pavarësisht nga qëllimi i njësisë për t’i mbajtur ato deri në maturim.

Një zhvlerësim për rënie vlere të të drejtave për t’u arkëtuar krijohet atëherë kur është evidente që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje që t’i arkëtojë të gjitha shumat ashtu siç ishte parashikuar në termat fillestare të kërkesave për tu arkëtuar. Konsiderohen tregues të rënies së Vlerës së Llogarive të Arkëtueshme: Vështirësi të rëndësishme financiare të debitorit, ndoshta debitori ka hyrë në rrugën e falimentimit ose riorganizimit financiar, dhe moskryerja apo vonesat në pagesa. Shoqëria vlerëson çdo vit mundësinë e arkëtimit të llogarive të arkëtueshme për secilin klient dhe kur një Llogari e Arkëtueshme vlerësohet që nuk mund të arkëtohet, ajo regjistrohet në shpenzimet dhe në Llogarinë e kërkesave të Arkëtueshme, duke e fshirë këtë të drejtë nga librat e saj kontabël. Nëse më pas arkëtohet shuma të cilat janë çregjistruar, atëherë kreditohen shpenzimet e shitjes dhe administrimit për këto shuma. Shoqëria nuk ka njohur zhvlerësim të klientëve për vitin 2019.

Kërkesa te tjera të arkëtueshme njihen kur njësi ka një të drejtë për të marrë mjete monetare ose përfitime në të ardhmen si pasojë e një ngjarje të ndodhur, përveç shitjes, dhe kur vlera e përfitimeve matet në mënyrë të besueshme. Kërkesat e tjera të arkëtushme vlerësohen në hyrje dhe në bilanc me të njëjtën parime si dhe llogaritë e arkëtueshme.

**A BI ESSE Sh.p.k.**  
**PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUdhËN USHTRIMORE QË PERFUNDOI MË**  
**31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

SHUMAT NE LEK, PERNDRYSHJE SHKRUHET

### **3.2. Aktivet financiare – Vazhdim**

Shoqëria një aktiv financiar në përputhje me SKK 3 e çregjistron pjesërisht ose totalisht (nuk paraqitet më në bilancin kontabël) në rastin kur ajo parashikon që nuk do gjenerohen më flukse monetare nga ky aktiv dhe nuk ka më kontrollin mbi aktivin ose ka transferuar të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin.

### **3.3 Transaksionet me Monedhat e huaja**

#### *Monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes*

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare vlerësohen duke përdorur monedhën e mjedisit ekonomik kryesor në të cilin operon njësisia (“monedha funksionale”). Pasqyrat financiare të shoqërisë paraqiten në Lekë (All), e cila është monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes.

#### *Transaksionet dhe tepricat në monedhë të huaj*

Transaksionet në monedha të huaja të kryera gjatë vitit janë konvertuar në lek me kursin e këmbimit të vendosur në datën e transaksionit. Elementët monetarë gjendje në datën e ndërtimit të PF dhe që janë në monedhë origjinale të huaj janë përkthyer në lek me kursin e fund vitit, i cili paraqitet:

Data / Monedha	31 Dhjetor 2019/All	31 Dhjetor 2018/ All
Euro	121.77	123.42
USD	108.64	107.82

Diferencat e rezultuara nga përkthimi në fund të vitit i gjëndjeve monetare në monedhë të huaj janë paraqitur në rezultatin e periudhës raportuese.

### **3.4 Inventarët**

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SKK 4 Inventarët”, kur shoqëria i kontrollon apo zotëron ato ekonomikisht apo ligjërisht, kur mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet në lidhje me to, dhe kur kostoja matet në mënyrë të besueshme. Në hyrje inventarët e mallrave dhe materialeve vlerësohen me koston e tyre që përfshin tërësinë e çmimeve neto të blerjes dhe të shpenzimeve të bëra deri në sjelljen e tyre në shoqëri kur këto kosto mund të identifikohen me besueshmëri. Në bilanc inventarët paraqiten të vlerësuara me vlerën më të vogël midis koston dhe cmimit të parashikuar të shitjes minus koston e parashikuar të shitjes. Cmimi i parashikuar i shitjes është e ardhura e parashikuar nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit. Shoqëria përdor metodën kontabël të inventarizimit periodik dhe metodën e koston mesatare për matjen e inventarëve gjendje. Në datën e ndërtimit të PF shoqëria ka vlerësuar që kosto e inventarit është më e ulët se cmimi i parashikuar i shitjes minus koston e parashikuar të shitjes.

**A BI ESSE Sh.p.k.**  
**PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QË PERFUNDOI MË**  
**31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

SHUMAT NË LEK, PËRNDRYSHË SHKRUIHET

### **3.5 Aktivet Afatgjata Materiale dhe Jomateriale (AAM/AAJM)**

#### **(i) Njohja dhe Vlerësimi**

AAM dhe AAJM vlerësohen në hyrje me kosto historike. Ato paraqiten në Bilanc me koston e amortizuar (koston historike minus amortizimin e akumuluar). Kosto historike përfshin shpenzimet që i përkasin direkt blerjes së elementëve të këtyre aktiveve. Kostot e kryera më vonë përfshihen në vlerën e mbartur të aktivitetit ose njihen si një aktiv më vehte, sipas rastit, vetëm nëse është e mundur që ky element të sjellë hyrje të përfitimeve të ardhshme ekonomike në shoqëri dhe kostoja e këtij elementi të mund të matet me besueshmëri. Të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit regjistrohen si shpenzime në periudhën që ato kryhen dhe paraqiten në zërin e shpenzimeve operative.

#### **(ii) Amortizimi**

Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale llogaritet dhe njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën lineare. Ndërsa për të gjithë zërat e tjerë amortizimi llogaritet dhe njihet me metodën e vlerës së mbetur, me norma të cilat janë të përafërta me jetegjatesinë mesatare të parashikuar të përdorimit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen. Normat e amortizimit të përdorura janë të paraqitura si më poshtë:

	<b>Norma Amortizimit %</b>	<b>Metoda Llogaritjes</b>
Ndërtesa	5	Me Vlerën e mbetur
Makineri e pajisje	20	Me Vlerën e mbetur
Mjete Transporti	20	Me Vlerën e mbetur
Mobilje Orendi e të Tjera	20	Me Vlerën e mbetur
Pajisje Informatike	25	Me Vlerën e mbetur

### **3.6 Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra**

Shoqëria zbaton politikën e shtyrjes të shpenzimeve të cilat do të sigurojnë të ardhura në periudhat e mëvonshme. Po ashtu ajo shpërndan në vartësi të përdorimit dhe sigurimit të të ardhurave edhe shpenzimet e parapaguara.

### **3.7 Detyrimet**

Shoqëria i klasifikon detyrimet në afatshkurtra dhe afatgjata.

Detyrimet afatshkurtra klasifikohen në Hua të marra, Detyrime tregtare/Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve dhe detyrime të tjera. Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tregtare të tjera njihen fillimisht me vlerën e blerjes minus zbritjet e mundshme dhe më pas në bilanc paraqiten të vlerësuara me koston e amortizuar.

Në detyrimet e tjera përfshihen detyrimet jotregtare dhe huamarrjet përveç llogarive të pagueshme dhe detyrimeve të tjera tregtare.

Detyrimet ndaj shtetit për tatimet dhe për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore janë paraqitur me shumën e tyre të llogaritur sipas kërkesave ligjore në fuqi më datën e ndërtimit të pasqyrave financiare.

**A BI ESSE Sh.p.k.**  
**PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUdhËN USHTRIMORE QË PERFUNDOI MË**  
**31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

SHUMAT NE LEX, PERNDRYSHJE SHKRUHET

---

### **3.7 Detyrimet -Vazhdim**

Huamarrjet afatshkurtër njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit. Huat më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas. Shoqëria paraqet si hua afatshkurtër edhe këstet afatshkurtëra të huave afatgjata.

Huat klasifikohen si detyrime afatshkurtra, me përjashtim në rast se Shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

Detyrimet afatgjata vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuar me koston e amortizuar. Çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas duke përdorur metodën e interesit efektiv.

### **3.8 Të Ardhurat dhe Shpenzimet**

Të ardhurat nga shitja e mallrave, produkteve dhe shërbimeve njihen kur ekziston një marrëveshje e vazhdueshme me klientin, dorëzimi është realizuar apo shërbimi është kryer, dhe rreziqet e përfitimit e pronësisë së mallit apo produktit i janë transferuar klientit, vlera e të ardhurave mund të matet me besueshmëri dhe është e mundur që përfitimet që lidhen me transaksionin mund të hyjnë në Shoqëri. Të ardhurat nga shitja e mallrave janë njohur në Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve atëherë kur klienti ka pranuar faturën ose mallin sipas kontratës si dhe kur janë kryer shërbimet pavarësisht nëse ato janë faturuar, arkëtuar ose jo. Ato janë njohur me vlerën e mallrave apo shërbimeve të shitura spas faturës minus zbritjet tregtare. Të ardhurat nga interesat janë njohur kur ato janë llogaritur apo njohur siaps deklarimeve bankare. Të ardhurat dhe shpenzimet nga kurset e kembimit janë njohur në momentin e arkëtimit apo shlyerjes së klientëve, furnitorëve apo këmbimit të monedhave të ndryshme, si dhe në konvertimin e elementëve financiarë e monetare në fund të vitit. Ato paraqiten në pasqyrën e të ardhurave më vlerën neto të tyre. Shpenzimet janë njohur në Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria ka zbatuar parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtës periudhë. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar ato.

### **3.9 Shpenzime për personelin**

#### **(i) Kontributet për Sigurime Shoqërore dhe të ngjashme**

Shoqëria, gjatë aktivitetit të saj normal, kryen pagesa në emer të saj dhe të punonjësve të saj për kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në pajtim me legjislacionin në fuqi. Shpenzimet përkatëse të bëra në emër të Shoqërisë ngarkohen në Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve me ndodhjen e tyre. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar ato.

### **3.10 Provizionet**

Provizioni njihet kur Shoqëria ka një detyrim aktual që ka lindur nga një ngjarje e shkuar, shlyerja e të cilit pritet të shoqërohet me dalje të burimeve dhe mund të behet një vlerësim relativisht i sakte i shumës së detyrimit. Shoqëria nuk ka njohur provizione në Pasqyrat Financiare të vitit 2019.

**A BI ESSE Sh.p.k.**  
**PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QË PERFUNDOI MË**  
**31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

SHUMAT NE LEK, PERNDRYSHJE SHKRUHJET

### 3.11 Tatimi mbi fitimin

Shoqëria zbaton kërkesat e SKK 11 për tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë. Shoqëria për llogaritjen e tatimit aktual mbi të ardhurat bazohet në normën e tatimit që përcaktohet në ligjet për tatimet që janë në fuqi në datën e ndërtimit të bilancit kontabël.

Fitimi i tatueshëm është llogaritur duke u bazuar në rezultatin kontabël dhe duke e korigjuar atë me shpenzimet e panjohura sipas përcaktimit të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”. Menaxhimi vlerëson periodikisht gjendjen lidhur me tatimin e rimbursueshëm duke u bazuar në situatat në të cilat rregullimet tatimore që zbatohen janë subjekt i interpretimit dhe përcakton provizione kur e shikon të përshtatshme bazuar në shumat që parashikon të paguajë ndaj zyrës së tatimeve. Shoqëria llogarit në çdo datë të ndërtimit të PF diferencat e përkoshme mdisi vlerës kotnabël dhe asaj të tatueshme të aktiveve dhe detyrimeve. Nëse dalin diferenca ajo llogarit tatimin e shtyrë. Për vitin 2019 shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë.

### 3.12. Vijimësia e biznesit

Shoqëria ka ndërtuar PF bazuar në parimin e vijimësisë së biznesit. Shoqëria vlerëson të gjithë faktorët që mund të ndikojnë në vijimësinë e biznesit të saj të paktën për 12 muajt e ardhshëm të tillë si vështirësitë financiare, shitjen e pjesëve të rëndësishme të biznesit, etj. Gjatë vitit 2020 në Shqipëri, por edhe në botë ka patur një situatë të ndërprerjes së ëprkohshme të aktivitetit për shkak të pandemisë së Covid 19. Drejtimi i shoqërisë ka vlerësuar se ecuria e biznesit, situata e saj financiare, lloji i aktivitetit të saj nuk do të preken në ata masë sa të rrezikojnë ndërprejren e aktivitet të saj.

## 4. Mjetet Monetare

Në këtë grup të aktiveve paraqitet gjendja e mjeteve monetare në llogaritë bankare dhe në arkat e shoqërisë. Një paraqitje e përmbledhur e tyre jepet në tabelën vijuese:

Pershkrimi i Llogarive	2019	2018
Mjete monetare në banke	8,719,622	17,221,382
Mjete monetare në arkë	902,275	10,553,257
<b>Total</b>	<b>9,621,897</b>	<b>27,774,639</b>

### 4.1 Mjetet Monetare në Arke

Gjendja e likuiditeteve në arkë në vitin 2019 përbëhet nga shumat e mjeteve monetare në monedhën kombëtare lek dhe në euro që ndodhen gjendje në shoqëri në 31.12.2019 dhe paraqitet si vijon:

Pershkrimi i Llogarive	31 Dhjetor 19	31 Dhjetor 18
Arka ne lek	488,976	10,202,407
Arka ne euro	413,299	350,850
<b>Total</b>	<b>902,275</b>	<b>10,553,257</b>

Gjendja e Mjeteve Monetare të shprehura në monedhë të huaj është konvertuar me kursin e datës 31.12.2019 të shpallur nga Banka e Shqipërisë dhe diferencat janë paraqitur në rezultatin e periudhës.

**A BI ESSE Sh.p.k.**  
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUdhËN USHTRIMORE QË PERFUNDOI MË  
31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NE LEX, PERNDRYSHJE SHKRUHET

#### 4.2 Mjetet Monetare në Llogaritë Bankare.

Konvertimi i gjëndjes bankare në monedhë të huaj është bërë me kursin e datës 30.12.2019 të shpallur nga Banka e Shqipërisë. Diferencat e rezultuara nga rivlerësimi i tyre janë sistemuar në rezultatin e periudhës. Përbërja e llogarisë “Banka” sipas monedhave të shprehura në lek paraqitet si vijon:

Pershkrimi I Llogarive	31 Dhjetor 19	31 Dhjetor 18
Llogari Rrjedhese prane Bankave	8,460,543	11,348,083
Llogari Rrjedhese prane Bankave	259,079	5,873,299
	-	-
<b>Total</b>	<b>8,719,622</b>	<b>17,221,382</b>

#### 5. Aktive Të Tjera Financiare Afatshkurtra

Aktive të Tjera Financiare Afatshkurtra më datë 31 Dhjetor 2019 paraqiten në Bilanc me vlerën e tyre të arkëtueshme. Përbërja e tyre jepet në vijim:

Aktive të tjera financiare afatshkurtra	Viti 2019	Viti 2018
Kërkesa të arkëtueshme	175,046,589	135,928,976
Kërkesa të tjera nga të tretët	60,993,531	30,820,991
<b>TOTALI</b>	<b>236,040,120</b>	<b>166,749,968</b>

#### 5.1 Kërkesa Të Arkëtueshme

Në këtë zë paraqiten kërkesat ndaj klientëve gjendje të paarkëtuar në 31 Dhjetor 2019. Një paraqitje e përbërjes së kërkesave të arkëtueshme ndaj klientëve jepet në tabelën vijuese

Pershkrimi I Llogarive	2019	2018
Kliente lek	169,227,903	129,580,087
Kliente Euro	5,818,686	6,348,889
<b>Total</b>	<b>175,046,589</b>	<b>135,928,976</b>

#### 5.2 Kërkesa Të Tjera nga Të Tretët

Në këtë zë të Bilancit paraqiten kërkesat ndaj të tretëve që nuk lidhen me shitjet si dhe kërkesat ndaj Institucioneve Shtetërore për tatime e taksa. Në tabelën vijuese jepet një paraqitje e përbërjes së tyre:

Pershkrimi I Llogarive	2019	2018
Parapagime Tatim Fitimi	12,880,204	-
Shteti TVSH e zbritshme	4,584,009	1,200,991
Te tjera	43,529,151	29,620,001
<b>Total</b>	<b>60,993,365</b>	<b>30,820,991</b>

Në zërin “Të tjera” paraqiten shumat e paradhëniesve të dhëna punonjësve, parapagimet e dhëna për blerje, te drejtat për tu arketuar ende të pafaturuara, etj.

#### 6. Inventarët

Shoqëria i njeh Inventarët e mallrave dhe materialeve kur merr përsipër riskun dhe përfitimet nga to, pavarësisht nëse i ka paguar apo jo. Në hyrje Inventarët vlerësohen me koston e cila përfshin cmimin e blerjes, taksat dhe shpenzimet e transportit. Gjëndja e Inventarit në fund të vitit vlerësohet me më të voglën midis koston së blerjes dhe Vlerës Neto të Realizueshme VNR. Sipas drejtimit të Shoqërisë kostoja është më e vogël se Vlera Neto e Realizueshme prandaj

**A BI ESSE Sh.p.k.**  
**PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUdhËN USHTRIMORE QË PERFUNDOI MË**  
**31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

SHUMAT NE LEK, PERNDRYSHJE SHKRUEHET

### 6. Inventarët-Vazhdim

Inventarët janë paraqitur në Bilanc me koston e tyre. Përdor metodën kontabël të inventarizimit periodik dhe kosto mesatare.

Inventarët paraqesin gjëndjen e mallrave në magazinë dhe në pikat e shitjes të Shoqërisë si dhe të Inventarit të imët dhe lëndë djegëse (karburant) gjëndje sipas pasqyrës vijuese. Inventarët vlerësohen me koston sipas FIFO.

Pershkrimi	2019	2018
Te tjera gjendje inventari - inventar i imet	1,213,675	1,109,482
Mallra per rishitje	451,563,745	463,924,536
Parapagime per furnizime	1,375,625	3,909,680
<b>Total</b>	<b>454,153,045</b>	<b>468,943,698</b>

### 6.1 Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Në këtë zë paraqiten shpenzimet e parapaguara, kryesisht për qiranë për ambjentet e saj, të cilën shoqëria e ka parapaguar dhe do ta njohë në rezultatin e viteve të ardhme sipas afatit të kontratave.

Pershkrimi	2019	2018
Shpenzime te periudhave te ardhme	3,735,630	5,414,448
<b>Total</b>	<b>3,735,630</b>	<b>5,414,448</b>

### 7. Aktivet Afatgjata Materiale dhe Jo-Materiale

Në vijim paraqiten pasqyrat në lidhje me lëvizjet e AAM-ve gjatë vitit 2019 si dhe amortizimet përkatëse.

#### Pasqyra e levizjes së AAM dhe AAJM për vitin 2019

Aktive afatgjata materiale dhe jomateriale	Gjendje 31.12.2018	Shtesa gjatë vitit nga blerjet	Riklasifikimi	Daljet gjatë viti	Gjëndja më 31.12.2019
Licenca	1,302,505	37,000		-	1,339,505
Toka	339,082,844	626,442		-	339,709,286
Ndërtime, instalime të përgj.	31,314,906	-		-	31,314,906
Insta teknike, makineri, pajisje	28,652,310	7,819,573		4,904,845	31,567,038
Mjete transporti	52,432,199	406,567		2,762,282	50,076,484
Paisje zyre e orendi	20,543,528	3,046,825		1,484,837	22,105,517
Paisje informatike	20,240,933	5,431,085		2,806,335	22,865,684
Të tjera AAM	18,385,132	369,789		170,075	18,584,847
AAM ne Proces	20,393,797	-		-	20,393,797
<b>TOTALI</b>	<b>532,348,155</b>	<b>17,737,282</b>		<b>12,128,374</b>	<b>537,957,064</b>



**A BI ESSE Sh.p.k.**  
**PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUdhËN USHTRIMORE QË PERFUNDOI MË**  
**31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

SHUMAT NE LEK, PERNDRYSHJE SHKRUEHET

## 7. Aktivet Afatgjata Materiale dhe Jo-Materiale-Vazhdim

### Pasqyra e llogaritjes së amortizimeve të AAM dhe AAJM për vitin 2019

Amortizimi i aktiveve afatgjata	Shtesat			Shuma 31.12.2019
	31.12.2019	Amortizimi vjetor	Riklasifikime	
Licenca	574,208	196,301		770,509
Ndërtime, instalime të përgj.	11,994,846	966,003		12,960,849
Instalime teknike, makine, pajisje	24,842,812	893,453	4,607,705	21,128,560
Mjete transporti	30,492,682	4,242,668	1,936,734	32,798,616
Paisje zyre e orendi	13,515,944	1,443,646	1,484,837	13,474,753
Paisje informatike	14,018,197	2,043,981	2,806,335	13,255,843
Të tjera AAM	15,156,027	652,801	170,075	15,638,753
<b>TOTALI</b>	<b>110,594,728</b>	<b>10,438,853</b>	<b>11,005,686</b>	<b>110,027,895</b>
<b>VKN 31.12.2019</b>	<b>421,753,428</b>			<b>427,929,169</b>

Në bilanc Aktivet Afatgjata paraqiten për çdo grup me vlerën neto pa amortizimin e akumuluar. Llogaritja e amortizimit të AAM është bërë duke marrë parasysh kohën e hyrjes së AAM. Normat e amortizimit të përdorura janë në përputhje me kërkesat e Ligjit 8438 date 28.12.1998, "Për Tatimin mbi te ardhurat". Shiko edhe shenimin 3.5

## 8. Detyrimet Afatshkurtra

Paraqitja e tyre në Bilancin kontabël jepet në tabëlën vijuese:

DETYRIMET AFATSHKURTRA	Viti 2019	Viti 2018
Hua dhe Obligacione Afatshkurtra	235,268,215	164,600,548
Të Pagueshme ndaj Furnitorëve	151,257,709	168,054,554
Të pagueshme ndaj punonjësve	324,031	2,283,449
Detyrime Tatimore	4,524,870	14,643,568
Të tjera detyrime	87,872,242	2,655,205
Parapagimet e arkëtuara	1,355,990	-
<b>TOTALI</b>	<b>480,603,057</b>	<b>352,237,324</b>

### 8.1 Hua dhe Obligacione Afatshkurtra

Paraqet tepriçën e llogarisë së huave (overdraft / linjë kredie) të marra gjëndje në 31.12.2019. Paraqitja si vijon:

Pershkrimi	2019	2018
Huat afatshkurtra - Overdrafte	225,901,311	141,815,310
Huamarrje afat-shkurtra - Kesti 12 mujor	9,366,904	22,785,238
Hua afat-shkurter nga ortakut	-	-
<b>Total</b>	<b>235,268,215</b>	<b>164,600,548</b>

**A BI ESSE Sh.p.k.**  
**PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUdhËN USHTRIMORE QË PERFUNDOI MË**  
**31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

SHUMAT NE LEX, PERNDRYSHE SHKRUHET

### 8.2 Të Pagueshme ndaj Furnitorëve

Në këtë zë të bilancit paraqiten detyrimet ndaj furnitorëve ende të papaguara në fund të vitit 2019. Detyrimet në monedha të huaja janë konvertuar me kursin e datës së fundit të vitit publikuar nga Banka e Shqipërisë dhe diferencat janë sistemuar në rezultatin e periudhës. Një paraqitje analitike e këtyre detyrimeve sipas monedhave jepet në tabelën vijuese:

Pershkrimi	2019	2018
Furnitore ne leke	23,310,602	19,552,562
Furnitore ne Euro	127,947,107	148,501,992
<b>Total</b>	<b>151,257,709</b>	<b>168,054,554</b>

### 8.3 Të pagueshme ndaj punonjësve

Në këtë zë paraqiten detyrimet për pagat e llogaritura dhe të papaguara për stafin drejtues dhe punonjësit për muajin dhjetor. Në fund të vitit 2019 shoqëria ka detyrime për pagat e papaguara ndaj punonjësve të cilat janë paguar në muajin Janar 2020.

### 8.4 Detyrime Tatimore

Detyrimet Tatimore përbëhen nga detyrimet ndaj Institucioneve Shtetërore për Tatime e Taksa si dhe nga detyrimet për kontributet e detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore e Shëndetsore. Këto detyrime paraqiten si vijon:

Pershkrimi	2019	2018
Shteti Sigurimet Shoqërore e Shëndetsore	2,066,230	1,762,433
Shteti Tatim Mbi te Ardhurat Personale	1,761,303	890,677
Detyrim Tatim ne burim	697,337	578,011
Tatim fitimi	-	11,412,447
<b>Total</b>	<b>4,524,870</b>	<b>14,643,568</b>

Detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe për tatimin mbi pagat paraqesin shumat të llogaritura për pagat e punonjësve për muajin dhjetor 2019, të cilat janë paguar në janar të vitit 2020. Detyrimi Tatim ne burim paraqet shumën e tatimit në burim gjendje në fund të vitit dhe që është paguar në janar 2020.

### 8.5 Të Tjera Detyrime

Një paraqitje analitike e këtij zëri jepet në vijim:

Pershkrimi	2019	2018
Te ardhura te paperfituara	1,959,930	1,959,930
Detyrime te tjera	863,624	635,550
Dividente per tu paguar	85,048,688	59,725
<b>Total</b>	<b>87,872,242</b>	<b>2,655,205</b>

Zëri "Të ardhura të papërfituara" për shumën 1,960 mijë lek paraqet shumën e marrë nga kompensimin e shtetëzimit të një pjese të Tokës në emër të Drejtorisë së Rrugëve për të cilën ende nuk është bërë regjistrimi në emër të kësaj Drejtorie.

**A BI ESSE Sh.p.k.**  
**PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUdhËN USHTRIMORE QË PERFUNDOI MË**  
**31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

SHUMAT NE LËK, PERNDRYSHJE SHKRUHET

### 8.5 Të tjera Detyrime -Vazhdim

Zëri “Të tjera detyrime”, përfaqësojnë detyrimet ndaj ortakëve për interesat e maturuara më 31.12.2019 në lek lidhur me huatë afatgjata të marra prej ortakëve të Shoqërisë (referojuni pasqyrës të pikës 9). Shoqëria në këtë grup paraqet edhe dividendët e deklaruar ende të papaguara, për të cilat i ka shlyer detyrimet për tatimin në burim, dhe që do të paguhen vitin e ardhshëm.

### 9. Huamarrjet Afatgjata

Paraqet huatë afatgjata marrë nga ortakët e Shoqërisë dhe kredia e marrë tek ABI Bank shlyhet gjatë vitit 2020 dhe është klasifikuar si huamarrje afatshkurtër. Perberja analitike e tij paraqitet si më poshtë:

Pershkrimi	2019	2018
Huamarrje nga ortakët	42,010,650	29,620,800
Huamarrje bankare afatgjata-ABI Bank	-	9,493,827
<b>Total</b>	<b>42,010,650</b>	<b>39,114,627</b>

### 10. Kapitallet e Veta

Gjendja e kapitaleve të veta më 31 dhjetor 2019, sipas zërave kryesorë të tyre të paraqitura në bilancin kontabël paraqitet si vijon:

Pershkrimi	2019	2018
Kapitali i paguar	450,000,000	450,000,000
Rezerva ligjore	40,585,570	33,772,078
Rezerva te tjera	69,502,260	79,092,308
Kapital i falur	150,000	150,000
Fitimi (Humbja) i/e vitit financiar	48,628,333	136,269,844
<b>Total</b>	<b>608,866,154</b>	<b>699,284,230</b>

Përbërja dhe ndryshimi i kapitaleve të veta gjatë vitit 2019 jepet në pasqyrën vijuese:

	Kapitali aksionar	Rezerva statusore dhe ligjore	Fitimi i paspërndarë	Rezerva të tjera	Kapitali i falur	Totali
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2017</b>	450,000,000	26,597,378	72,680,421	52,534,059	150,000	601,961,858
Efkti i ndrysh. në politikat kontabël						
<b>Pozicioni i rregulluar</b>	<b>450,000,000</b>	<b>26,597,378</b>	<b>72,680,421</b>	<b>52,534,059</b>	<b>150,000</b>	<b>601,961,858</b>
Fitimi neto i periudhës kontabël			136,269,844			136,269,844
Dividendët e paguar/deklaruar				-38,947,472		-38,947,472
Transferime në rezervën e detyrueshme ligjore						-
Transferime në rezervën e detyrueshme statutore		7,174,700		69,046,400		76,221,100
Transferime në rezervën të tjera			-72,680,421	-3,540,679		-76,221,100
Emetim i kapitalit aksionar						-
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2018</b>	<b>450,000,000</b>	<b>33,772,078</b>	<b>136,269,844</b>	<b>79,092,308</b>	<b>150,000</b>	<b>699,284,230</b>

**A BI ESSE Sh.p.k.**  
PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QË PERFUNDOI MË  
31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE

SHUMAT NË LEK, PËRNDRYSHË SHKRUHET

## 10. Kapitalet e Veta-Vazhdim

Efekti i ndrysh. në politikat kontabel							
Pozicioni i rregulluar	450,000,000	33,772,078	136,269,844	79,092,308	150,000	699,284,230	
Fitimi neto i periudhës kontabel			48,628,333			48,628,333	
Dividendët e paguar/deklaruar			-			-	
Transferime në rezervën e detyrueshme ligjore			129,456,352	-9,590,057		-139,046,409	
Transferime në rezervën e detyrueshme statutoare		6,813,492	-6,813,492			-	
Transferime në rezerva të tjera						-	
Emetim i kapitalit aksionar						-	
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2019</b>	<b>450,000,000</b>	<b>40,585,570</b>	<b>48,628,333</b>	<b>69,502,251</b>	<b>150,000</b>	<b>608,866,154</b>	

## 11. Të Ardhurat dhe Shpenzimet

Për periudhën kontabël që mbyllet me 31 dhjetor 2019 shoqëria ka kryer shpenzime dhe ka realizuar të ardhura në përputhje me aktivitetin e vet të cilat janë paraqitur në Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve të ndërtuar sipas natyrës.

### 11.1 Shitjet Neto

Gjatë vitit 2019 Shoqëria ka realizuar të Ardhura kryesore që përbëjnë shifrën e afarizmit të saj, nga shitja e mallrave e paisjeve elektrike brënda dhe jashtë vendit, të cilat neto nga zbritjet, paraqiten si në vijim:

Pershkrimi	2019	2018
Te ardhura nga shitja e mallrave	1,152,789,582	1,147,577,169
<b>Total</b>	<b>1,152,789,582</b>	<b>1,147,577,169</b>

### 11.2 Të Ardhura të Tjera

Përberja e këtij zëri paraqitet si vijon :

Pershkrimi	2019	2018
Të ardhurat nga shërbime të tjera	40,491,361	28,816,595
Te ardhura te tjera	369,720	-
Te ardhura nga shitja e AAM	30,917	2,791,951
<b>Total</b>	<b>40,891,998</b>	<b>31,608,546</b>

### 11.3 Mallrat, Lëndët e para dhe Shërbimet

Paraqet koston totale të blerjes së mallrave të shitura të llogaritur si vijon:

Kosto e mallrave të shitura	Viti 2019	Viti 2018
Kosto totale e blerjeve gjatë periudhës	949,008,031	879,737,078
Ndryshimi i gjëndjeve se mallrave (+/-)	-14,790,653	-37,695,798
<b>TOTALI</b>	<b>934,217,378</b>	<b>842,041,280</b>

Në koston e blerjeve përfshihet çmimi neto i blerjeve, shpenzimet e transportit, taksat de detyrimet e tjera doganore dhe cdo shpenzim tjetër deri në vendin e depozimit. Referojuni edhe shënimit 3.4

**A BI ESSE Sh.p.k.**  
**PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUdhËN USHTRIMORE QË PERFUNDOI MË**  
**31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

SHUMAT NË LËK, PËRNDRYSHË SHKRUHET

**11.4 Shpenzime të Personelit**

Shpenzimet e personelit paraqiten si më poshtë:

Përshkrimi	2019	2018
Shpenzime per paga	78,817,957	67,264,742
Shpenzimet e sigurimeve shoqërore e shëndetsore	10,820,281	9,616,175
<b>Total</b>	<b>89,638,238</b>	<b>76,880,917</b>

Në Shpenzimet për personelin, janë përfshirë shpenzimet për paga, shpërblime dhe Sigurime Shoqërore e Shëndetsore paguar punonjësve të Shoqërisë gjatë vitit 2019. Shoqëria për punonjësit e saj, ka llogaritur, deklaruar dhe paguar në përputhje me kërkesat ligjore, Tatimin mbi pagat, kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetsore.

**11.5 Shpenzimet e amortizimeve dhe zhvlerësimeve**

Në këtë zë paraqiten shpenzimet e amortizimit të aktieve afatgjata materiale dhe jometariale të shoqërisë për vitin 2019. Referojuni edhe shënimit 3.5 dhe 7.

**11.6 Shpenzime të Tjera nga Veprimtaritë e Shfrytëzimit**

Në këtë zë janë përfshirë shpenzimet e tjera të aktivitetit kryesorë të shoqërisë. Përbërja e tyre jepet në tabelën në vijim:

Përshkrimi	Viti 2019	Viti 2018
Furnitura nëntrajtme e shërbime	93,507,255	98,226,361
Shpenzime për taksa	1,230,239	1,260,365
Shpenzime të tjera rrjedhëse	7,757,058	9,010,670
Vlera kontabël e AAM të shitura	-	3,388,375
<b>TOTALI</b>	<b>102,494,552</b>	<b>111,885,771</b>

**(i) Furnitura, Nëntrajtme dhe Shërbime**

Në zërin Shpenzime për furnitura, nëntrajtme dhe shërbime janë përfshirë disa zëra shpenzimesh që janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Përshkrimi	Viti 2019	Viti 2018
Energji elektrike, ujë	8,023,703	8,492,946
Blerje të ndryshme	11,168,645	24,672,759
Qira	44,437,640	38,017,640
Riparime të ndryshme	7,735,667	5,991,617
Prime të sigurimit	3,399,148	3,547,044
Shërbime të ndryshme	11,003,630	9,063,204
Reklama, njoftime	31,416	79,506
Dieta, udhëtime	3,197,160	3,434,070
Shpenzime postare, telekomunikacion	1,769,135	1,844,900
Transport për shitje	1,479,227	1,992,224
Shërbime - komisione bankare,	1,261,885	1,090,450
<b>TOTALI</b>	<b>93,507,255</b>	<b>98,226,361</b>

**A BI ESSE Sh.p.k.**  
**PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUdhËN USHTRIMORE QË PERFUNDOI MË**  
**31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

SHUMAT NË LEK, PËRNDRYSHË SHKRUHET

**(ii) Shpenzime për Tatime dhe Taksa**

Në këto shpenzime janë përfshirë pagesat si në tabelën e mëposhtme:

Përshkrimi	Viti 2019	Viti 2018
Taksa-tarifa vendore	631,923	625,925
Taksë regjistrimi	163,974	122,108
Taksa të ndryshme, pulle, QKB,,leje qark,	177,987	74,327
Taksë kolaudimi	115,114	264,304
Taksë peshe, disvolta, etj	141,242	173,701
<b>TOTALI</b>	<b>1,230,239</b>	<b>1,260,365</b>

Shpenzimet për taksat doganore, akciza dhe taksa skanimi për vitin 2019, nuk paraqiten në këtë zë pasi ato janë përfshirë në koston e blerjeve të mallrave (shënimi 11.3).

**(iii) Shpenzime të tjera**

Në shpenzimet e tjera janë përfshirë shpenzimet që pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Përshkrimi	Viti 2019	Viti 2018
Subvencione e ndihma të dhëna	335,000	271,748
Shpenzime përfaqësimi	5,926,215	7,563,243
Penalitete, gjoba	112,046	17,472
Të tjera të panjohura	1,383,797	1,158,207
<b>TOTALI</b>	<b>7,757,058</b>	<b>9,010,670</b>

**11.7 Të Ardhura dhe Shpenzime për interesa**

Në zërin të Ardhura dhe Shpenzime për interesa janë përfshirë diferencat ndërmjet të Ardhurave dhe Shpenzimeve për interesat. Paraqitja si vijon:

Pershkrimi	2019	2018
Te Ardhura nga Interesi	268	8,486
Shpenzime nga Interesi	(5,898,185)	(5,435,369)
<b>Total</b>	<b>(5,897,917)</b>	<b>(5,426,883)</b>

**11.8 Fitimet dhe humbjet nga kursi i kembimit**

Në këtë zë të shpenzimeve paraqiten fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit për transaksione të ndodhura gjatë vitit 2019, dhe për tepricat e llogarive monetare dhe aktiveve financiare në monedhë origjinale të huaj, në datë 31.12.2019. Paraqitja e tyre jepet si në tabelë:

Pershkrimi	2019	2018
Fitimi nga Kurset e kembimit	12,522,880	36,310,580
Humbje nga Kurset e kembimit	-5,608,398	-7,008,678
<b>Total</b>	<b>6,914,482</b>	<b>29,301,902</b>

**A BI ESSE Sh.p.k.**  
**PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIU DHËN USHTRIMORE QË PERFUNDOI MË**  
**31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

SHUMAT NE LEK, PERNDRYSHJE SHKRUHET

## 12. Fitimi

Shoqëria ka rezultuar me një Fitim Kontabël para tatimit prej 57,909 mijë lekë dhe me Fitim pas tatimit mbi fitimin prej 48,628 mijë lekë. Shoqëria ka llogaritur një Tatim mbi fitimin prej 9,281 mijë lekë.

Për llogaritjen e Tatimit mbi fitimin të vitit 2019 Shoqëria ka bërë rregullimet e nevojshme fiskale, duke konsideruar si të panjohura për qëllime fiskale një sërë Shpenzimesh. Fitimi i tatueshëm i Shoqërisë për vitin 2019 rezultoi 61,871,882 lek.

Llogaritja e Shpenzimeve të panjohura, e Fitimit të tatueshëm dhe e Tatimit mbi fitimin për vitin 2019 paraqitet si më poshtë:

Pasqyra e rezultatit tatimor	Viti 2019	Viti 2018
<b>Fitimi/Humbja e vitit</b>	<u>57,909,115</u>	<u>161,252,085</u>
<b>Korrigjimet e rezultatit sipas ligjit tatimor:</b>		
<i>Shpenzime të tjera</i>	1,383,984	1,158,207
<i>Gjoha Penalitete e te ngjashme</i>	112,046	17,472
<i>Shpenzime Pritje Percjellje</i>	2,466,737	4,120,511
<b>Totali i shpenzimeve të panjohura</b>	<u>3,962,767</u>	<u>5,296,191</u>
<b>Fitimi/Humbja i tatueshme para mbartjes se humbjes fiskale</b>	<u>61,871,882</u>	<u>166,548,276</u>
Humbja fiskale nga viti		
Fitimi/Humbja fiskale e vitit	<u>61,871,882</u>	<u>166,548,276</u>
Norma e tatimit aktual mbi fitimin	<u>15%</u>	<u>15%</u>
Tatimi aktual mbi fitimin	<u>9,280,782</u>	<u>24,982,241</u>
<b>Shpenzimi kontabel i tatimit mbi fitimin</b>	<u>9,280,782</u>	<u>24,982,241</u>
<b>Rezultati neto i bilancit</b>	<u>48,628,332</u>	<u>136,269,844</u>

## 13. Transaksionet me Palët e Lidhura

Sipas statutit të shoqërisë, organi më i lartë vendimmarrës është asambleja e ortakëve. Shoqëria drejtohet nga administratori i saj.

Gjatë vitit 2019 transaksionet me palët e lidhura konsistojnë në huan e marrë nga ortakët e saj, dividendët si dhe llogaritja për interesat lidhur me këto hua. Një paraqitje e këtyre transaksioneve dhe tepricave të tyre në fund jepet si më poshtë

## Tepricat ne Bilanc

Pershkrimi	2019	2018
Dividende	85,048,688	-
Detyrime te tjera	863,624	635,550
Huamarrje afatshkurter nga ortakët	42,010,650	29,620,800
<b>Total</b>	<u>127,922,962</u>	<u>30,256,350</u>

**A BI ESSE Sh.p.k.**  
**PASQYRAT FINANCIARE PËR PERIUDHËN USHTRIMORE QË PERFUNDOI MË**  
**31 DHJETOR 2019 DHE SHËNIMET SHPJEGUESE**

*SHUMAT NE LEK, PERNDRYSHJE SHKRUHET*

**13. Transaksionet me Palët e Lidhura - vazhdim**

**Pasqyra e Te ardhurave dhe shpenzimeve**

Pershkrimi	2019	2018
Shpenzime per interesa	1,016,029	748,234
<b>Total</b>	<b>1,016,029</b>	<b>748,234</b>

**14. Ngjarjet mbas datës së bilancit**

Pas datës së mbylljes së periudhës raportues për shkak të pandemisë botërore të Covid 19, dhe të masave të marra nga qeveria Shqiptare por edhe të atyre të vendeve Europiane dhe botërore, aktiviteti i shoqërisë u reduktua për një periudhë disa mujore gjatë të cilës shoqëria punoi me një kapacitet jo të plotë. Kjo pritet që të sjellë në periudhën pasardhëse edhe një rënie të shitjeve dhe si pasojë edhe ulje të rezultatit të shoqërisë, efektet e të ciles është e vështirë të maten në shumën dhe kohë, por që nuk rrezikon aspak vijimësinë e biznesit.

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së bilancit që do të ishte e nevojshme që të paraqiteshin si rregullime ose informacione shtesë në këto pasqyra financiare.